



Nr.regj. 7791/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE VUSHTRRI, gjyqtari duke e vendosur ne procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Veli Karaca nga Vushtrria, për kundërvajtje nga neni 17 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen, dhe kontrollimin e pasurise te zyrtareve te larte public dhe kontrollimin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74,195, dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 23.10.2012 bjen kete:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Veli Veli Karaca i lindur me dt. 11.03.1958 në Kurillove tani banon ne Vushtrri rr “Shales” nr. 10, saherbyes civil, i martuar, te kryer akademis ushtarake, gjendjen ekonomike mesatare me pare jo i denuar.

ESHTË PËRGJEGJËS

Sepse i pandehuri Veli Karaca si zyrtar i larte public ne komunen e Vushtrris ka qene i obliguar qe ta beje deklarimin e pasurise deri me datën 31.03.2012 per vitin paraprak dhe ta njoftoi Agjencionin Kunder Korrupcionit, mirepo i njeiti nuk e ka permbush obligimin ligjor te parapar me ligjin per deklarimin prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise

me cka ka bërë kundërvajtje mos deklarim i pasurise nga 17 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen, kontrollimin e pasurise te zyrtareve te larte public dhe kontrollimin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar.

dhe per kete:

DENOHET

Me gjobë në shum prej 1000 / njemije/ € të cilin gjobë i pandehuri ka për të pague në afatin prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë në favor të KGJK, nëse gjobën e shqiptuar nuk e pagan në afatin prej 15 ditësh e njeita konformë nenit 5 të LMK-ës do t’i zavendsohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke llogaritur nga 15 € për një ditë burge.

Konformë nenit 109 al. 2 të LMK-ës i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 € në afat të njejt me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi të iu dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencioni Kunder Korrupcionit Prishtine ka parashtrur kërkesën nr. 01-2542/12 dt. 02.08.2012 për iniciimin e procedures kundërvajtëse ndaj të pandehurit Veli Karaca nga Vushtrria, për kundërvajtje, neni 17 paragrafi 1 pika 14.1 të Ligjit larte cekur.

Gjyqtari e inicioi procedurën për kundërvajtje duke e marrë në pyetje te pandehurin me c’rast i njeiti ka deklarue: une nuk kam qene i informuar nga Agjencioni Kunder Korrupcionit se duhet me e mbushe nje formular te caktuar dhe te jap informata lidhur me pasurin time si anetar i Kuvendit Komunal ndersa gjendja ime ekonomike nuk ka ndryshuar sepse une jetoj nga nje page mujore si sherbyes sivil dhe kam konsiderue se nuk eshte e nevojshme perseritja e te dhanave t’ mija lidhur me pasurin kurse me vone jam informue permes VEB faqes se ekziston nje formular per deklarimin e pasuris dhe kam mendue se a duhet ta plotesoje vetem ata zyrtar public te cilte kane ndryshime ne pasurin e tyre.

Per vertetimin e drejte te gjendjes faktike keshte marre ne pyetje perfaqesusi i Agjencionit Kunder Korrupcion Enis Sadiku i cili deklaroi ne lidhje me kerkesen e ushtruar kunder te pandehurit Veli Karaca nga Vushtrria antar i Kuvendit Komunal dhe zyrtar public i cili ka per obligim me ba deklarimin e pasurise dhe me njoftue organin tone me kohe nga Kuvendi Komunal kemi sigurue listen se ky person ban pjese ne zyrtarte e larte public kurse per dergimin e formulareve ketyre personave eshte e obliguar pika e kontaktit e caktuar nga komuna e Vushtrris ku zyrtari kontaktues eshte Ilmi Zeqiri dhe se ky person duhet te pyetet se a e ka marre formularin per deklarimin e pasuris personi i pandehur.

03-3887/12/02
feng


Deshmitari Ilmi Zeqiri si person kontaktues i caktuar nga komuna per kontakte me organin Anti Korrupcion ne Prishtine deklaroi se: une per te gjithë personat e komunes tone te cilet jane zyrtar public dhe kane per obligim me i dhan informatat mbi pasurin ju kam drejtue sekretaris se kuvendit qe me kohe te gjithë personave qe figurojne ne listen e zyrtareve te larte public tua dergojne formularte e nevojshem per deklarimin e pasurise dhe jam i bindur se kete e kane kryer dhe nuk besoi qe i pandehuri Veli Karaca ka mbet pa u njoftue.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, marrjes në pyetje të pandehurit, perfaqesuesit te ushtruesit te kerkeses dhe deshmitarit, gjyqtari në mënyrë të plotë dhe të drejtë e vërtetoi gjendjen faktike dhe konstatoi se i pandehuri nuk e ka kryer obligimin ligjor te cilin e ka pas per deklarimin e pasurise dhe njoftimin e Agjencionit antikorruptcion kurse arsyetimin e te pandehurit e vlersoi si jo te bazuar dhe jo te argumentuar dhe te njejtin gjyqtari nuk e muarr parasysh kurse nga deshmit e personave te cekur me larte u vertetue qe i njejt e ka kryer kundervajtjen me te cilen ngarkohet, per cka të njejtin e shpalli përgjegjës dhe e denoi me gjobën e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të denimit gjyqari i vlersoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-s dhe të pandehurit ja shqiptoi këtë denim duke llogarit se edhe me këtë denim do të arrihet efekti i denimit ndaj të pandehurit që i njejt në të ardhmen të mos kryej kundervajtje të këtilla apo të ngjajshme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE VIKTIERE OSO VIKTIERE
dt. 23.10.2012



KSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund të parashtroj i pandehuri dhe ushtruesi i kërkesës në afatin prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, ankesa parashtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.